

Tropojë/ Lëndë narkotike dhe shumë parash në automjet, arrestohen dy 23-vjeçarët: Çfarë ju gjet në banesë



12:59 - 10 Korrik, 2023



Policia e Tropojës ka vënë në pranga 23-vjeçarë pasi u kapën në automjet me lëndë narkotike kanabis, të ndara në doza të gatshme për shitje, si dhe një shumë parash në euro, që dyshohet se është përfituar nga kjo veprimtari kriminale.

Gjatë kontrolleve në banesën e një prej shtetasve policia gjeti dhe sekuestroi një armë zjarri pushkë dhe municion luftarak.

Njoftimi i policisë:



Tropojë/Finalizohet operacioni policor i koduar “Xhirot”, sekuestrohen një pushkë, municion luftarak, doza të lëndës narkotike cannabis sativa dhe një shumë eurosh e përfituar nga shitja e këtyre dozave.

Posedonin në kundërshtim me ligjin, armë zjarri dhe lëndë narkotike, arrestohen në flagrancë dy 23-vjeçarë.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Tropojë, në vijim të kontrolleve të mbështetura nga inteligjenca policore, me qëllim parandalimin e ngjarjeve kriminale, si dhe për nxjerrjen përpara përgjegjësisë penale, të shtetasve që posedojnë sende të kundërligjshme, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar “Xhirot”, si rezultat i të cilit u arrestuan shtetasit:

23-vjeçarët të dy banues në fshatin Sopot, Tropojë.

Gjatë kontrolleve në automjetin me të cilin qarkullonin këta shtetas, shërbimet e Policisë gjetën një sasi lënde të dyshuar narkotike cannabis sativa, të ndarë në doza të gatshme për shitje, si dhe një shumë parash në euro, që dyshohet se ishte përfituar nga kjo veprimtari kriminale.

Në vijim të veprimeve procedurale për këtë rast, gjatë kontrolleve në banesën e një prej shtetasve u gjet një armë zjarri pushkë dhe municion luftarak.

Arma e zjarrit, municioni luftarak, dozat e lëndës narkotike dhe shuma e eurove u sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, për veprime të mëtejshme.[r.t/abcnews.al](https://www.abcnews.al)

- *Kryesore
- Aktualitet
- Armë
- Dy 23 Vjecare
- Lend Narkotike
- Municion
- Shume Paarash

Tropoje

Të ngjashme

Google po përgatit një armë sekrete kundër ChatGPT

Zgjerimi i kapaciteteve të prodhimit të armëve në BE

Gjermani më shumë para për armë e më pak për fëmijë



12:05 - 11 Korrik, 2023

“Putin, Haga ju pret”, pankarta varet në ndërtesën ku po zhvillohe...

12:04 - 11 Korrik, 2023

Gjendet e vdekur 33-vjeçarja në Tiranë, dyshimet e para

12:03 - 11 Korrik, 2023

Lidhje mes tensioneve në veri dhe përgjimeve? Abazi: Qeveria Kurti ka...

11:56 - 11 Korrik, 2023

“Përgjimi fillimi i majës së Ajsbergut”, deputeti Abazi: Kusari ka hyrë në bisedim...

11:54 - 11 Korrik, 2023

Miratohet reforma në drejtësi, protesta në Izrael

11:51 - 11 Korrik, 2023

Shqipëria Sot me Fabiola Hoxhën, (11/07/2023)

11:50 - 11 Korrik, 2023

SHBA, 37 milionë njerëz përballen me temperatura ekstreme

11:44 - 11 Korrik, 2023

Macron: Do të dërgojmë në Kiev raketa me rreze të gjatë veprimi

ABC NEWS AL
info@abcnews.al
+355 67 400 9040

Rreth nesh

Abcnews.al është website kryesor i lajmeve në Shqipëri. Pjesë e televizionit ABC, redaksia e Abcnews.al ka të shenjtë verifikimin e lajmit në mënyrë të pavarur nga gazetarët tanë para publikimit. Me një redaksi të riorganizuar, Abcnews.al mundëson një mbulim të plotë të zhvillimeve më të fundit nga vendi dhe bota, përmes një stafi të kualifikuar dhe profesional. Saktësia në informim mbështetet edhe me risitë më të fundit në lidhje me mediat online duke e bërë Abcnews.al një media avangardë në vend. NUIS/NIPT K01711004F

Harta e faqes

Aktualitet

Botë

English

Politikë

Ekonomi

Life

Rajon

Emisione

Plus

Sport

Moti

Opinion

